




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

Nga sesioni i dëgjimit të përgjithshëm publik me temën “Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore”, mbajtur më 4.11.2024.

Në takim morën pjesë: Osman Bllaca - koordinator i dëgjimeve publike, Luljeta Selimi, Premtime Preniqi - zyrtare për barazi gjinore.

Takimin e hapi dhe e kryesoi z. Osman Bllaca.

Osman Bllaca – duke e hapur takimin për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore tha se ky draft veçse ka kaluar në Kuvendin komunal dhe ka marrë miratimin për konsulta paraprake, është në platformën e diskutimeve publike prej datës 15 deri më datë 14 nëntor ku mund të shkruani atje vërejtje, sugjerime dhe komentet apo çkado që keni në lidhje me draftin dhe pastaj i shqyrtojmë dhe i analizojmë së bashku me ekipin i cili e kanë hartuar këtë plan të veprimit.

Premtime Preniqi – gjatë prezantimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore tha se Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore është plan i vitit 2024 /26, është përgatitur nga zyrtarët e kryeqytetit, kemi pasur edhe nga Komiteti për Barazi Gjinore. Ajo njëherit tha se në këtë Plan Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore e kemi filluar me një vendim të kryetarit të kryeqytetit, pastaj kemi bërë analizën dhe vlerësimin e situatës, përcaktimin e fushave kryesore të ndërhyrjes, konsultimet paraprake, konstatimi i veprimeve të parashikuara deri më tani, postimi në faqet e internetit të kryeqytetit për komentet dhe sugjerimet nga individë dhe grupe të interesit dhe mbajtja e diskutimeve publike. Një rol të rëndësishëm po luan mbështetja nga Wuen Women Kosova përmes projektit që financohet nga fondet e Bashkimit Evropian.

Ajo në vazhdim tha se ky plan është përshtatur dhe ka pasur për bazë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave drejtëpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, programin e Kosovës për barazi gjinore, instrumente dhe mjete të BE-së, të fokusuara tek barazia gjinore si pjesë e procesit të integritetit, veçanërisht atë që përmban veprimet që duhen të ndërmerren në nivel lokal, siç është edhe Karta për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale. Ky dokument si Plan i Veprimit për Barazi Gjinore është një mjet praktik pra për lokalizimin e dokumenteve të rëndësishme kombëtare, por edhe ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore. Hartohet një proces gjithëpërfshirës i kryeqytetit i cili përmban dhe reflekton sfidat dhe arritjet në kryeqytet për ngritjen e barazisë gjinore, është pasqyrë e qartë e rolit dhe përgjegjësisë të domosdoshme. Ajo mes tjerash ceku objektivat strategjike siç janë: promovimi i barazisë gjinore, fuqizimi i grave dhe vajzave, fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale të punësimit, etj. Gjithashtu ajo foli edhe për bashkëpunëtorët dhe anën ligjore nga është bazuar plani.

Nita Ferizi Sadiku – organizata Eco kos Women- tha se ne si organizatë kemi në fokus avancimin dhe përmirësimin e pozitës së gruas në Kosovë. E kemi shikuar planin e veprimit dhe na vjen mirë që kryeqyteti vetëm se ka filluar me këtë iniciativë. Mirëpo atë çka e kemi vërejt që mungon në plan është kryesisht në objektivin nr. 4 te promovimi i shëndetit seksual dhe riprodhues. Ajo në vazhdim tha se ne si organizatë kemi bërë një studim në vitin 2021 ku tregon që menaxhimi i higjienës menstruale tek vajzat dhe gratë, vetëdijësimi i kësaj çështjeje është i ulët, si dhe qasja në produkte sanitare menstruale është e ulët në Kosovë. 15% e grave dhe vajzave nuk ndjekin punën dhe shkollën gjatë periudhave të tyre menstruale për arsye se nuk mund të sigurojnë peceta higjienike menstruale. Për këtë arsye e shohim të arsyeshme të propozojmë të shtohet edhe një nënobjektivë tek objektiva e katërt pra rritja e vetëdijësimit të higjienës menstruale dhe përmirësimi i qasjes në produkte sanitare menstruale me qëllim që edhe shkollat publike në Kosovë të furnizohen me peceta sanitare higjienike menstruale me qëllim që të përmirësohet qasja, vijueshmëria e vajzave të jetë konstante e mos të jetë një pengësë që mos të marrin pjesë në mësimet e tyre gjithashtu edhe për gratë të ndjekin punën e tyre.

Premtime Preniqi – duke iu përgjigjur znj. Ferizi – Sadiku tha se ne e kemi pasur këtë edhe më herët si pikë në Planin e veprimit, mirëpo për shkak se me drejtoreshën e mirëqenies sociale kemi biseduar, kemi pritur mos po gjendet ndonjë donator, por kjo ka dështuar edhe faktikisht për atë arsye edhe e kemi larguar prej planit për shkak se nuk mundet me u realizua brenda këtyre dy viteve. Ajo në vazhdim tha se kur do e bëjmë monitorimin e planit aktual për të ardhmen kemi me pasur gjithmonë për bazë këtë çështje që me e futur në planet e ardhshme.

Osman Billaca – Premtime ne çdoherë si institucion dhe institucionet tjera çka i kemi relevante po hartojmë strategji, plane, kurrikula, po hartojmë dokumente të cilat po janë shumë të rëndësishme, shumë të bukura, shumë të begatshme në përmbajtjen e tyre, por e jona është që ne më pas nuk po e bëjmë një përcillje, nuk po e bëjmë një follover të tyre edhe kjo pastaj po na mbetet në njëfarë forme si vetëm të shkruara në letër. E jona është që me pasur sa më shumë përcjellje pasi që je e përkushtuar dhe je prej punonjësve të mira të komunës, kështu që këto plane që po i bëjmë me i realizuar edhe në praktikë jo vetëm t'i kemi si norma juridike.

Premtime Preniqi – tha se ne qysh kur kemi filluar me e hartuar këtë dokument e kemi pasur për qëllim që çka të vendoset në këtë plan me qenë i realizueshëm e jo se ne faktikisht edhe jemi në bashkëpunim me Wuen Women, ku edhe e përmenda që kemi me bërë një monitorim jo vetëm njëvjeçar, por kemi me bërë monitorim gjashtëmuor apo në perioda të ndryshme. Ajo në vazhdim tha se për atë arsye kemi dashur me i paraqit gjithmonë objektivat të cilat janë të realizueshme e jo diçka çka nuk mundemi me realizuar se këtu neve na pengon buxheti, pastaj nuk e dimë se a kemi mundësi me i gjetë donatorët. Kështu që kemi menduar që në qoftë se diçka çka e bëjmë dhe e realizojmë këtë vit edhe e arrijmë qëllimin bile 90% të planit me realizuar, atëherë në të ardhmen vetëm me i shtuar pikat tjera të cilat mundemi me i realizuar edhe me bë përmirësimin e këtij plani e jo me na mbetur sikursepse kur është në pyetje barazia gjinore asgjë nuk mbetet në letër, të gjitha realizohen.

Osman Billaca – pasi që nuk kemi diskutues të tjerë që duan të marr fjalën, atëherë e përmbylim këtë takim. Mirupafshim në takimet tjera!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim publik lidhur me Planin lokal të veprimtimit për barazimin gjinorë 2024-2026

4 nëntor, 2024

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	keomara	Salku - Topalla			
2	Nita	Ferizi Sadiku			
3	FATLINDA	HaxhiTA			
4	Ajrover	Bisovani			
5	Violeta	Salku			
6					
7					
8					
9					
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen! *